**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-23-4552-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut**

# ANKESË

## *1.* Identifikimi i ankuesit*

| | |
|---|---|
| Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj | **"Internat Security Association"SH.P.K.** |
| NUI | **601073042** |
| Adresa | **Mustafë Kruja nr.3** |
| Vendi | **PRISHTINË** |
| Kodi postar | **10000** |
| Numri Telefonit | |
| Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj | **Rajmonda Kurtaj** |
| Adresa elektronike | **info@securityisa.org** |
| Data e parashtrimit të ankesës | **21.12.2023** |

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

Ankesa i përket grupeve:

**Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut**

**B05- Njoftimi për kontrate: 22.05.2023**

**2. Afati për dorëzim te tenderit: 12.06.2023**

**3. Kriteret e dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët**

**4. Procesverbali i Hapjes se Ofertave: 12.06.2023**

**5. B58- Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Dhënie të Kontratës OE: INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION SH.P.K : 02.08.2023**

**6. Njoftim për pezullim të aktivitetit te prokurimit:18.08.2023**

**7. Ankesa e OE: DEFENCE SECURITY SH.P.K. Nr. 593/23, dërguar në OSHP: 18.08.2023**

**8. Ankesa e OE: Kompania e Sigurimit Fizik "Security Code" SH.P.K Nr.594/23**
**dërguar ne OSHP: 18.08.2023**

**9. Ankesa e OE: "S.I.G" SH.P.K. Nr. 597/23, dërguar ne OSHP: 18.08.2023**

**10. Vendimi i Panelit Shqyrtues OSHP: 2023/0593 i datës 16.11.2023**

**11. B58- Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Dhënie të Kontratës Grupin e OE: DEFENCE SECURITY SH.P.K.:07.12.2023**

**4**

***4.* Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

***5.* Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

***Po*** ☐ ***Jo*** ☒

***6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve***

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1 - Qëllimi,
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Neni 61 - Tenderët Jo-normalisht i Ulët,
Neni 116 - Procedurat e vendim-marrjes, paragrafi 6.
Shkeljet e dispozitave të Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik, janë:
Neni 40 -Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Neni 41 - Tenderët Jo-normalisht të Ulët
42. Njoftimi i Tenderuesve / Kandidatëve
Shkeljet e dispozitave të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik
Neni 11 Tenderet jo normalisht te ulet

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Më datën **07.12.2023** , Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës pas Ri-vlerësimit të ofertave , në Platformën e E-prokurimit ka bere publikimin e Formularit - **B58 - Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues.**

**Në ketë vendim, Autoriteti Kontraktues - Korporata Energjetike e Kosovës, ka shkruar së shpërblen me kontrate Grupin e OE: " DEFENCE SECURITY SH.P.K: International Security AAH SH.P.K, ne vlere totale të ofertës, 2,746,970.14 Euro me TVSH.**

Autoriteti Kontraktues, formularit B58 - Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të cilin e ka publikuar në Platformën e E - Prokurimit , nuk ja ka bashkangjitur Letrat Standarde përkatëse për Tenderuesit ashtu siç e kërkon neni **42.3** – **Rregullorja 01/2022 për Prokurim Publik.**

Autoriteti Kontraktues Në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar që na ka dërguar përmes Platformës së E-Prokurimit me datën **07.12.2023,** veçmas, si arsyeje të eliminimit të

kompanisë ton nga aktiviteti i prokurimit ka shënuar:

"Konforme vendimit te OSHP-se numër 2023/0593 eliminoheni nga ky aktivitet i prokurimit pasi qe shujta ne DT është kërkuar te mos jete me e ulet se 2 euro ndërsa ju keni kalkuluar shujtën e punëtoreve me çmimin 1.13 euro ne përgjigjen e dhëne pas pyetjes nga Autoriteti Kontraktues gjë qe është ne kundërshtim me kërkesat e dosjes se tenderit.
Komisioni i rivlerësimit nuk e ka pa te arsyeshme te ju drejtohet me pyetje sqaruese pasi qe ne dokumentet e lendes shihet qe komisioni paraprak i Autoritetit Kontraktues ju është drejtuar me shkrese lidhur me çmimin e ofruar te ofertës dhe ne përgjigjen e juaj keni dhëne shujtën nen shumën e kërkuar ne dosjen e tenderit e cila ka qene 2 Euro."

# Pretendimet tona ankimore janë:

## Pretendimi 1:

Arsyeja e eliminimit nga ky aktivitet i prokurimit të kompanisë ton, INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION SH.P.K, gjate fazës së Ri vlerësimit të ofertave, duke ju referuar vendimit të **OSHP-së , numër 2023/0593,** nuk qëndron për faktin së nuk është i bazuar në legjislacionin primar dhe sekondar të prokurimit publik.

Sipas vendimit të OSHP-së , numër **2023/0593**, lënda është kthyer në Ri-vlerësim dhe kthimi i një aktiviteti të prokurimit në Ri-vlerësim nga ana e OSHP-së, nuk nënkupton që me doemos duhet të ndryshohet rezultati fillestar. Në rastin konkret nuk nënkupton që të ndryshohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës **02.08.2023,** kur Autoriteti Kontraktues ka shpërblyer me kontrate kompaninë ton - INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION SH.P.K.

Prandaj, arsyeja e eliminimit të kompanisë tone nga aktiviteti i prokurimit gjate fazës se Ri-vlerësimit të ofertave, duke ju referuar vendimit të OSHP-së numër **2023/0593** është në **kundërshtim të plote** me nenin **116, paragrafi 6 i LPP** dhe **nenin 40, paragrafi 40.2 të Rregullorja 01/2022 për Prokurim Publik**.

**Përshkrim i nenit 116, paragrafi 6 të LPP**

1. Një vendim i OSHP-së për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

**Përshkrim i nenit 40, paragrafi 40.2 të Rregullorja 01/2022 për Prokurim Publik.**

40.2 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve**. Kjo gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së, përfshirë një urdhër për ri-vlerësim. Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.**

## Pretendimi 2:

Arsyeja e eliminimit nga ky aktivitet i prokurimit të kompanisë ton, INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION SH.P.K, gjate fazës së Ri vlerësimit të ofertave, së gjeja kërkesa në Dosje të Tenderit ka qene së shujta e punëtoreve nuk mund të jete me pak së 2 Euro, ndërsa kompania jon në sqarimet që ka dërguar të AK gjate vlerësimit të pare të ofertave ka kalkuluar 1.13 euro, edhe ky arsyetim nuk qëndron për faktin së nuk është i bazuar në Kërkesat e Autoritetit Kontraktues që ka kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate, prandaj është në kundërshtim të plote me legjislacionin primar dhe sekondar të prokurimit publik.

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit të Aneksi 1- SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, lidhur me shujtën ka shënuar në tri paragrafë :

**Në piken 4- faqe 22** , ka shënuar:

“ Kontraktori obligohet te furnizoje edhe një shujtë te ngrohte për çdo ndërrim”.

**Në piken 10 - faqe 23 ka shënuar:**

"Për shujte dhe sigurim shëndetësor, OE është i obliguar qe para nënshkrimit te kontratës te sjell marrëveshjet paraprake për:

- Për sigurim shëndetësor me një kompani për sigurim shëndetësor
- Për shujte me një ofrues te shërbimeve te ushqimit. (kosto e shujtës ditore nuk mund te jete me e ulet se 2.00€)
  Vërejtje: Autoriteti Kontraktues gjate realizimit te kësaj kontrate do te monitorojë/përcjellë ne mënyre strikte përmbushjen e te gjitha kërkesave te specifikimit teknik si dhe deklaratave te dhëna ne oferte. Ne rast te dështimit te respektimit te këtyre kërkesave nga OE, Autoriteti Kontraktues do te marre masat e parapare ligjore qe i parasheh kontrata për rastet e tilla".

**Në faqen 24, ka shënuar:**

"AK është duke aktivizuar mensat për ushqim te punëtorëve te KEK-ut. Ne lidhje me ketë, pas aktivizimit te këtyre mensave, KEK rezervon te drejtën te obligoi OE-ne te ofroi shujtat e cekura me larte për punëtorët e sigurimit fizik nga mensat e KEK-ut me **një kosto te akorduar**.

OE janë te obliguar qe ne oferte me ane te një deklarate te zotohen se te përmbushin dhe do te përfillin te gjitha kërkesat dhe specifikat teknike te cekura me larte nga pika 1 deri tek 10, si dhe te gjitha kërkesat tjera te cekura ne ketë specifikim teknik. Plotësimi këtyre kërkesave është parakusht për fillimin e implementimit te kontratës" .

Bazuar në të gjitha këto kërkesa që Autoriteti Kontraktues i ka shënuar në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit, shume qarte shihet së kërkesa për shujtën 2 euro është **kërkesë obligative gjate realizimit të kontratës e jo kërkesë eliminuese (kalon/nuk kalon), gjate vlerësimit të ofertave**.

**Pse kjo kërkesë e AK konsiderohet si kërkesë obliguese vetëm për kompaninë që realizon kontratën?**

**Në piken 4- faqe 22**, Autoriteti Kontraktues ju ka referuar **" Kontraktori". Kontraktor,** është vetëm një Operator Ekonomik që është shpërblyer me kontrate dha ka nënshkruar kontrate me Autoritetin Kontraktues.

**Në piken 10 - faqe 23,** Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që për shujte dhe sigurim shëndetësor, OE është i obliguar që **para nënshkrimit të kontratës** të sjell marrëveshjet paraprake për: Për sigurim shëndetësor me një kompani për sigurim shëndetësor dhe për shujte

me një ofrues të shërbimeve te ushqimit. (kosto e shujtës ditore nuk mund te jete me e ulet se 2.00€)

Prandaj shume qarte shihet që kërkesa është obliguese vetëm për Operatorin Ekonomik që shpërblehet me kontrate dhe marrëveshja në mes të OE që është shpërblyer me kontrate dhe ofruesit të shërbimeve të ushqime, ku çmimi për shujte nuk mund të kontraktohet me pak së 2 euro, dhe se kjo marrëveshje dërgohet të Autoriteti Kontraktues **para nënshkrimit te kontratës.**

**Në piken 10 - faqe 23 , Autoriteti Kontraktues gjithashtu ka shënuar që** Autoriteti Kontraktues gjate realizimit të kësaj kontrate do te monitorojë/përcjellë ne mënyre strikte përmbushjen e te gjitha kërkesave te specifikimit teknik si dhe **deklaratave te dhëna ne oferte**. Në rast të dështimit të respektimit të këtyre kërkesave nga OE, Autoriteti Kontraktues do te marre masat e parapare ligjore qe i parasheh kontrata për rastet e tilla".

Edhe kjo kërkesë e Autoritetit Kontraktues, shume qarte e dëshmon së edhe kërkesa për shujtën dhe kërkesat tjera kane të bëjnë vetëm gjate **fazës së realizimit të kontratës** e kurrsesi nuk kane të beje me **fazën e vlerësimit apo ri vlerësimit të ofertave** dhe nuk mund të merren si kërkesa eliminuese - **Kalon/nuk kalon**.

**Në faqen 24, Autoriteti Kontraktues ka shënuar së ë**shtë duke aktivizuar mensat për ushqim të punëtorëve të KEK-ut dhe se, pas aktivizimit të këtyre mensave, KEK rezervon të drejtën të obligoi OE-ne të ofroi shujtat e cekura me larte për punëtorët e sigurimit fizik nga mensat e KEK-ut me një **kosto të akorduar**.

Edhe ky informim i Autoritetit Kontraktues së nëse aktivizohen mensat e veta, do te jete obligative që edhe punëtoret e sigurimit të kompanisë që do të nënshkruan me KEK të ushqehen në këto mesa me **një kosto të akorduar**, e dëshmon shume qarte së kemi te bëjmë me një kërkesë **gjate realizimit të kontratës** ku edhe **çmimi për një shujte mund të ndryshoj varësisht nga negociatat që do të zhvillohen në mes të KEK dhe kompanisë që do të nënshkruaj kontratën për shërbimet e sigurimit.**

Bazuar në kërkesa e shënuar në Aneksin 1, të Dosjes se Tenderit , e vetmja kërkesë që ka qene obligative që të dorëzohet së bashku me ofertën, **është kërkesa për dorëzimin e një deklarate** ku zotohen së do të përmbushin dhe do të përfillin të gjitha kërkesat dhe specifikat teknike të cekura me larte nga pika **1 deri tek 10**, si dhe të gjitha kërkesat tjera të cekura në Aneksin – të Dosjes së Tenderit.

Kompania e jone INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION SH.P.K, së bashku me ofertën ka dorëzuar (jo një), po tri DEKLARATA.

1. Deklarate ku **deklarojmë së do i  përmbahemi në tërësi  Dosjes së Tenderit** të shpallur nga KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS;

2. Deklarate ku **deklarojmë së do ti përmbahemi të gjitha kushteve të ANEKS 1 të Dosjes së Tenderit Specifikimet Teknike të Detyrueshme**.

3. Deklaratë së pajtohemi me kërkesën e AK dhe zotohemi së do ti përmbushim të gjitha kërkesat e AK sipas sepcifikimeve teknike. Në ketë deklarate kemi shënuar komplet kërkesat- specifikat e shënuara nga AK në Aneksin 1- të Dosjes se Tenderit, ku në mesin e këtyre kërkesave kemi shënuar edhe kërkese që AK ka shënuar **në piken 10, që ka të beje me shujtën dhe koston e shujtës ditore e që është jo me e ulet së 2.00 €. Kjo dëshmon së edhe sa i përket shujtës, kemi deklaruar që gjate realizimit të kontratës do ta përmbushim edhe ketë kusht që shujta të mos jete me vlere me të ulet së 2.00 €.**

**Bazuar në të gjitha këto të dhëna dhe dëshmi të cilave ju referuam, shume qarte shihet së eliminimi i kompanisë ton gjate Ri-vlerësimit të ofertave me arsyetimin së nuk e kemi plotësuar kërkesën e AK që shujta të jete jo me pak së 2 Euro, është jo profesional, tendencioz dhe në kundërshtim të plote me dispozitat LPP, konkretisht nenit 56 , paragrafi 3 i LPP. Në asnjë rast Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejte ta diskualifikoj ose të përjashtoj nga procedura e prokurimit një Operator Ekonomik duke u bazuar në ndonjë kërkesë apo kriter që nuk është cekur në Njoftimin e Kontratës dhe Dosjen e Tenderit.**

Përshkrim i nenit 56 paragrafi 3 i LPP

3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

## Pretendimi 3:

Duhet theksuar së gjate vlerësimit të pare të ofertave, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me dataren **19.06.2023** na ka dërguar Letrën Standarde për Sqarime të Tenderit, ku ka kërkuar që konforme nenit 61 të LPP ( Çmimet jo normalisht të ulëta), ka kërkuar një kalkulim detal se si kemi arritur të vlera e ofertës prej  2,720,579.85 €, ku në ketë kalkulim detal të përfshihen të

gjitha kostot çmimet e të cilave kane qene të fiksuara në Dosjen e Tenderit, si pagat sipas ligjit, shujte dhe sigurimit shëndetësor.

Në përgjigjeje që ju kemi dërguar Autoritetit Kontraktues me datën xxxxxx ne mënyre të detajizuar ju kemi sqaruar së si kemi ardhur deri te çmimi i ofertës tone.

Pasi Autoriteti Kontraktues ka pranuar sqarimet lidhur me analizën e çmimeve, është bindur së oferta e jone nuk mund të konsiderohet si oferte me çmim jo normalisht të ulet, ofertën tone e ka konsideruar si oferte te përgjegjshme si nga aspekti administrativ, teknik dhe financiar dhe ka marre vendim me datën **02.08.2023** që kompaninë tone INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION SH.P.K, ta shpërblej me kontrate.

Edhe në ketë Kërkesë për Rishqyrtim po ju sqaroje edhe nje here sa i përket kalkulimit të çmimit të shujtës.

Llogarisim edhe po të jenë 278.25 punëtor në 24 orë me kalkulimin 278.25 punëtor në 24 orë x 1.69 euro qëkur i shtohet TVSH 18% çmimi për një shujte del te jete 2.00 euro shujta. (TVSH **është e zbritshmi** dhe nuk mund të merret si shpenzim dhe për këtë pjesë sepse eshë shpenzimi cili bëhet për çdo muaj deri në përfundim e kontratës dhe TVSH qe na faturon kompania qe kryen shërbimet e furnizimit me shujta për çdo muaj kur ta deklarojmë TVSH ne Administratën Tatimore te Kosovës, sipas Ligjit te TVSH e marrim si te zdritshme dhe nuk kalkulohet në asnjë mënyre si shpenzim.
Vazhdojmë tutje për të thjeshtësuar këtë çështje llogarisim në mënyrën më të thjeshtë si prsh. 22 ditë pune për një punëtor gjatë muajit me orar 8 orë dhe sipas ligjit të punës ashtu siq është kërkuar në dosjen e tenderit 22 * 1.69 euro = 37.18 euro, çmimi jonë I bie të jetë 34.47 euro (shif te analiza financiare) për mesatarisht 20 ditë pune në muaj , diferenca për shujtë I bie të jetë 2.71 euro apo në total të punëtorëve për çdo ditë 278.25 * 2.71 euro pa tvsh 754.0.5 euro pa tvsh me tvsh 889.79 (edhe pse pjesa e tvsh është e llogaritur në çmim e 34.47 euro) , që është e nevojshme të shtohen për çdo muaj, ne ju kemi cekur në fund të analizës se 2731.50 euro i kemi fitim për çdo muaj dhe i kemi lënë që ku do që të jetë nevoja të përdoren dhe në mund ti përdorim këto për plotësim të vlerës së shujtës. Pastaj në kemi deklaruar se do ti përmbahemi në tërësi kërkesave të dosjes së tenderit me deklaratën për specifikimet teknike dhe ashtu edhe do të bëjmë nëse shpallemi fitues për të dytën herë në këtë AP.

Sipas dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik - nenit 61 të LPP , nenit **41 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik** dhe nenit **11- të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik,** për tu konsideruar një tender jo normalisht i ulet duhet të plotësohen këto tri kushte:

i. Çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm;
ii. Çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**;

iii. Janë dorëzuar të paktën 3 (**tre) tenderë.**

Oferta e Grupit të OE " DEFENCE SECURITY SH.P.K: International Security AAH SH.P.K, që Autoriteti Kontraktues pas Ri vlerësimit te ofertave ka shpërblyer me kontrate është: **2,746,970.14** Euro me TVSH.

Oferta e kompanisë tone INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION SH.P.K që Autoriteti Kontraktues gjate Ri-vlerësimit të ofertave pa drejtësisht na ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit është: **2,720,579.85 €,**

**Nga të dhënat e shënuara me larte shihet së Oferta e kompanisë ton është vetëm për 0.97 % (2,746,970.14 /2,720,579.85 % - 100), me e ulet së oferta e Grupit te OE qe Autoriteti Kontraktues ka shpërblyer me kontrate.**

**Gjithashtu oferta e kompanisë ton është vetëm 2.19 % me e ulet se vlera e parashikuar nga vete Autoriteti kontraktues (2,780,159.38 €) buxhetin e caktuar të AK.**

**Prandaj konsiderimi i ofertës të kompanisë tone si oferte me çmim jo normalisht të ulet, është në kundërshtim të plote me nenit 61 të LPP , nenit 41 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik dhe nenit 11- të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik,**

**Gjithashtu konsiderimi i ofertës të kompanisë tone si oferte me çmim jo normalisht të ulet, ndërsa konsiderimi i ofertës e OE " DEFENCE SECURITY SH.P.K: International Security AAH SH.P.K, si oferte të përgjegjshme nga aspekt i çmimit, është diskriminim i hapur që i behet kompanisë tone, trajtim jo i barabarte, favorizim i një OE të caktuar, ku të gjitha këto veprime të AK janë në kundërshtim të plote me nenit 7 të LPP.**

## Pretendimi 4

Autoriteti Kontraktuex ne Dosjen e Tenderit të Fleta e të Dhënave (FDT të **neni 9.1 & 9.2- Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Kërkesa 3** dhe të Njoftimi për Kontrate - **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe Professional, kërkesa 3**. Pajisjet - Veturat patrulluese dhe ka kërkuar: Dëshmi qe tenderuesi posedon jo me pak se 4 (katër) vetura patrulluese te terrenit (4x4) . Te dëshmohet me kopje te certifikatave te regjistrimit te automjeteve ( lejeve të qarkullimit ).

Grupi i OE “ DEFENCE SECURITY SH.P.K: International Security AAH SH.P.K, qe AK, ka shpërblyer me kontrate me rastin e Ri vlerësimit të ofertave, konsiderojmë se nuk e ka plotësuar kërkesën 3- 4 (katër) vetura patrulluese te terrenit (4x4) .

Prej këtyre 3 automjete Skoda Dacia të cilat nuk janë në listë mund të jenë 4x4 dhe vetura tereni, mirëpo veturat e tjera vetura, ne nuk kemi gjetur se janë 4x4 dhe vetura tereni të gjitha janë vetura të vogla përpos Skoda Karoq e cila është veturë tereni mirëpo nuk është 4x4. Shiko të dhënat e automjetit i cili është i markës së njëjtë me motor 1.5 litër. Komisioni i Ri vleresimit te ofertave ,nuk e ka vërejture se libreza e prezantuar e automjetit nuk i përmban të dhënat e kubikazhit të automjetit, dhe këto të dhëna ose janë fshirë me qëllim ose janë fshehur nga prezantuesi i automjetit, këtë mbetet ta vlerësojë komisioni i i ri i Autoritetit Kontraktues. (shih kërkesën për rishqyrtim)

Andaj ne konsiderojmë se Grupi i OE “ DEFENCE SECURITY SH.P.K: International Security AAH SH.P.K, ka dorëzuar oferte të pa përngjeshëm pasi që nuk e plotëson kërkesën 3 të Dosjes se Tenderit dhe Njoftimit për Kontrate të kërkuar nga Autoritetit Kontraktues e qa ka te beje me veturat patrulluese.

Bazuar në të gjitha këto të dhëna të shënuara me larte konstatojmë së Autoriteti Kontraktues-Korporata Energjetike e Kosovës, ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e Tenderëve e ka bere ne kundërshtim të plote me nenin **59 te LPP** dhe Nenin **40 të Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik.-**

Gjithashtu Autoriteti Kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës vendimin për shpërblim me kontrate të Grupit të “ DEFENCE SECURITY SH.P.K: International Security AAH SH.P.K, me çmim të ofertës me të larte së sa të ofertës tone e kane bere ne kundërshtim të plote me **nenin 1 dhe nenin 6 të LPP.**

**Kërkojmë nga OSHP që të anulojë vendimin për dhënie kontrate dhe lëndën ta kthejë në rivlersim.**
**Ju lutemi që ankesa jonë të trajtohet në mënyrë të drejtë, ne do ti përdorim të gjitha mundësitë duke ju drejtuar edhe organve të tjera ët drejtësisë që kjo lëndë të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga të gjitha palët.**

*A keni bërë  kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** ☒ **Jo** ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.*

**Kerkesa per rishqyrtim**

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim*

**Jemi te dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës shume , shpenzimet e përgatitjes së Kërkesës për Rishqyrtim dhe fitimet e pritura.**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
*e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
*f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktu*